



REPUBLIKA E KOSOVËS	
KOMUNA E VUSHTRRI-S-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	54/16
Nr. i fq. / Br. st	- 9 -
Data: / Datum	31.03.2016
VUSHTRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E II-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 25 SHKURT 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:08.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrovë, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Mentor Ferizi, dhe Syzana Syla.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrovë – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrovë, kryesues i kuvendit –në kuadër të diskutimeve lidhur me rendin e ditës njoftoi anëtarët e kuvendit se afati për dorëzimin e formularëve lidhur me deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër-Korrupsion është nga data 1 deri me 31 mars të këtij viti, me ç' rast zyra e personelit shprëndajti formularët për të gjithë anëtarët e kuvendit. Tutje ai në kontekst të këtyre diskutimeve paraqiti një pikë shtesë të rendit të ditës të propozuar nga zyra ligjore e komunës si dhe propozoi që të bëhet një zhvendosje në shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditë e cila të shqyrtohet si pikë e dytë e rendit të ditës diskutimi i planit zhvillimor komunal.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për organizimin e shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal;
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për menaxhimin e parkingjeve publike (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për bartjen e mjeteve financiare të vitit 2015 në vitin 2016;
5. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2015;
6. Shqyrtim i Propozim-Vendimit për shpërndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive.

7. Shqyrtim i Propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
 8. Të ndryshme.
- a). Shqyrtimi i parashtresës për lidhjen e pajtimit gjyqësor me Istref Pushkollin.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për organizimin e shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal;

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së- paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se ky dokument ka një rëndësi mjaft të madhe në kuptimin e gjitha sektorëve të zhvillimit të komunës sonë për faktin se për herë të parë ky dokument është aprovuar në vitin 2009 nga ana e këtij kuvendi. Tute shtoi se ndryshimi i këtij dokumenti ka ardhur si rezultat i ndryshimit të disa ligjeve siç është ai për planifikim hapësinorë dhe ligjit për ndërtim por edhe pas skadimit të afatit ligjor të këtij dokumenti. Tute duke ju referuar ligjit të ndërtimit njoftoi se tani në fushën urbane nuk kemi plane rregulluese por kemi hartën zonale dhe plane rregulluese të hollësishme urbane. Pastaj njoftoi se në fillim të vitit 2015 është përgjedhur kompania e cila është marr me hartimin e këtij dokumenti dhe tani ky projekt është në do të shkoj në diskutim publik ku do të involvohen të gjitha grupet e interesit dhe komuniteti për të dhënë idetë e tyre për hartimin e një dokumenti sa më të mirë. Në fund ai ftoi të gjithë ekspertet e partive politike të përfaqësuara në kuvend por edhe nga shoqëria civile që angazhohen me propozimet e tyre se si ti qasemi planifikimit sa më të mirë urbanë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se ky dokument ka peshë dhe rëndësi të posaçme për komunën tonë. Tute shtoi se kuvendi i komunës ka aprovuar një mori dokumentesh të rëndësishme qoftë plane, programe dhe strategji por sikur këto dokument nuk po zbatohen dhe po mbesin vetëm në letër prandaj, apeloi që Plani Zhvillimor Komunal të është një plan gjithëpërfshirës për të gjitha subjektet ekonomik jo ekonomik shoqëri civile dhe aktert tjerë relevant e jo që ky dokument të mbetet vetëm një akt administrativ brenda administratës komunale i cili nuk do të na shërbej. Pastaj vlerësoi se PZHU-ja duhet të bazohet në matës real të zhvillimit tonë komunal. Në vazhdim ai ceku se në këtë dokument shumë të dhëna janë të përsëritur nga plani i mëhershëm edhe pse kemi ndryshime dhe atë janë si në kulturë në demografin e komunës dhe tanë këto ndryshime duhet të inkorporohen në këtë dokument. Mandej ceku se duhet të punohet në sensibilizimin e opinionit që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në debatet komunale për çështje kapitale të cilat përcaktojnë kahet e zhvillimit të komunës. Mandej vlerësoi se kemi ndryshime në kornizën afatmesëm si dhe në trendet demografike dhe këto të dhëna të reja dhe ndryshime duhet të harmonizohen me këtë dokument bazik në lëmin urban. Gjithashtu ndryshme kemi edhe sa i përket fushës së bujqësisë por edhe komosacioni 5.000 hektar tokë konsiderohet se janë nënë komasacion dhe këto toka duhet të trajtohen me këtë planë që ato të ruhen nga degradimet e mundshme. Një çështje tjeter e cila duhet të trajtohet është shpërndarja dhe koneksitetit i energjisë elektrike ku kemi mjaft shumë probleme për faktin se nëse në një fshat kemi problem me shtyllat elektrike atëherë disa lagje në qytet mbesin pa energji elektrike për shkak të shpërndarjes së dobët dhe sistemi të vjetruar. Pastaj kemi shumë vendbanime me emra të dyfishtë por kjo ndodh edhe me lumenjtë kësaj problematic duhet ti jepet zgjidhje me këtë dokument. Duke ju referuar planit në fjalë shtroj si çështje mjaft me peshë mbrojtje e tokave nga ndërtimet e egra dhe parcelimin e tokave bujqësore. Në fund tha se nëse është e nevojshme mund të thirret një seancë e veçantë ku do të

shqyrtohej në mënyrë të hollësishme Plani Zhvillimor Komunal me qëllim që të kemi një dokument sa më gjithëpërfshirës dhe të zbatueshëm për komunën tonë.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se në këtë dokument shumë gjëra janë të përsëritura dhe shtoi se kur i referohem fushës së kulturës atëherë del në pah fakti se në këtë planë janë të evidentuar shumë monumente historike që ekzistojnë por ka edhe atyre monumenteve të cilat janë evidentuar e të cilat nuk ekzistojnë si p.sh “sahat nulla”. Pastaj vlerësoi se monumentet e historisë më të re siç janë ato të UÇK-së nuk janë evidentuar dhe përfshirë në këtë planë të cilat duhet të futen në këtë dokument. Në fund tha se në këtë plan duhet të futen të gjitha elementet dhe kategoritë që bëjnë këtë planë të lehtë për tu zbatuar.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së-duke dhënë sqarime lidhur me çështjet e referuara nga anëtarët e kuvendit vlerësoi se deri në aprovin final të këtij dokumenti do të tentojmë që gjérat të cilat janë përsëritur të hiqen nga ky planë. Tësia shtoi se si ekzekutiv komunal i kanë bërë një analizë strategjisë lokale për zhvillim ekonomik 2013/2018 me të cilën është bërë një matje e zhvillimit se sa është zbatuar ky dokument që i njëjtë të inkorporohet në planin zhvillimor komunal. Pastaj vlerësoi se është mjaft shqetësuese zënia e tokës bujqësore me ndërtimë të egra. Lidhure me këtë problem ceku se është menduar që në bashkëpunim me Drejtorin për Kadastër ti vejmë vijat e kuqe duke e trajtuar çdo parcelë me këtë dokument. Në fund tha sete gjitha monumentet kulturore dhe historike do të inkorporohen në Planin Zhvillimor Komunal.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet hapja e diskutimit publik të Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë, e cila do të zgjasë tridhjetë (30) ditë .

2.Për Zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmerr masat e nevojshme për implementimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje.

3.Shqyrtimi i Draft Rregullores për menaxhimin e parkingjeve publike (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Vushtrrisë.

2.Diskutimi publik fillon nga data 01 mars 2016 dhe zgjatë deri më 21 mars 2016.

3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike (DSHP) që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin mars 2016.

4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për bartjen e mjeteve financiare të vitit 2015 në vitin 2016;

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime profesionale lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke, shtuar se në bazë të ligjit të buxhetit për vitin 2016 Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur propozimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2015 në vitin 2016 konform tabelave 4.1 dhe 4.2. Në vazhdim ai paraqiti të dhëna lidhur me bartjen e mjeteve financiare nëpër kategoritë dhe kodet buxhetore ekonomike. Në fund ai paraqiti përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit të parashtruara në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 22 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim barten mjetet e lira të mbetur nga viti 2015 në vitin 2016 në shumën prej 457,719.10€ në kategoritë ekonomike si në vijim:

1.1 Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111) në shumën prej 14,285.00€;

1.2 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë mallra dhe shërbime (kodi 130) në shumën prej 53,882.10€;

1.3 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzimet komunale (kodi 132) në shumën prej 5,057.35€;

1.4 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë subvencione dhe transfere (kodi 200) në shumën prej 10,200.00€;

1.5 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzime kapitale (kodi 300) në shumën prej 374,294.65€

1.6 Shuma e mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016 është gjithsejtë 457,719.10€

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat 4.1 dhe 4.2.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

5. Shqyrtimi i Informatës për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2015;

6. Shqyrtim i Propozim-Vendimit për shpërndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive;

Dibran Perçuku, nënkyrytar i komunës- tha se në kuadër të analizave qe ka bërë qeveria komunale kemi menduar që kërkesa Sabit Syles për financimin e projektit shkencorë-monografie “Batalioni IV Rexhep Musa” të subvencionohet me një shumë të mjeteve financiare në vlerë prej 5,000€. Prandaj lidhur me këtë çështje propozoi që bëhet zvogëlimi i

shumave të mjeteve financiare në disa pozicione dhe atë: në pozicionin “Dita e ZOSH” të merren 1,500 €, pastaj tek pozicioni “Botimi i librave publikimeve” shuma prej 2,000 € të barten dhe të dedikohen për projektin në fjalë, si dhe pozicioni “Stimulimi për sukseset e Klubeve” nga shuma totale prej 5700,00 € të merret një shumë prej 1500,00 €. Në fund ai arsyetoj se bartja dhe financimi i këtij projekti është i një rëndësie të posaçme për faktin se po ndriçohet lufta e UÇK-së dhe veçanërisht po hidhet dritë në masakrën e fshatit Studime.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket shpërndarjes së subvencioneve në sektorin e sportit dëshiron ta di cilat kanë qen kriteret për të përfituar këtë subvencion. Tutje shtoi se në këtë listë po shihet që nuk është bërë një kategorizim i sporteve që është një prej pikave fillestare për ndarjen e këtyre subvencioneve. Këtu shihet se kanë përfitua disa klube private të cilat po përfitojnë edhe nga vete sportistët që po i ushtrojnë pikërisht klubet e basketbollit, pavarësisht që me aprovin e rregullores i kemi liruar klubet sportive nga pagesa për shfrytëzimin e palestrës. Ndërsa te klubet e Volejbollit është një diskriminim në ndarjen e subvencioneve mes klubeve çka është ne pyetje a janë në pyetje militantet partiak apo çka , ku dihet se këto klube garojnë në të njëjtën kategori. Kërkoi një informatë lidhur me listën e klubeve sportive a janë te regjistruar në komunë, apo përfitojnë mjete nga komuna ndërsa ato që janë private ,në këtë rast komuna nuk ka te drejtë qe të ju ndaj mjete . Mendoj në te ardhmen tē bëhet një kategorizim më i mire i sporteve p.sh. 1. Ti dallojmë sportet olimpike dhe ato jo olimpike. 2. Të merren parasysh rezultatet 3. Numri i aktivitetave në vend dhe jashtë vendit. 4. Të shikohet në cilat liga garojnë. Në fund kërkoi një sqarim lidhur me shumën 5700 € që dedikohen stimulim për suksesin e klubeve, për cilat klube është fjalë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-tha se shpërndarja e këtyre subvencioneve nuk është bërë konform kritereve dhe se subvencionet po ndahen duke vënë në rend të parë petkun politik dhe partiak çka nuk do duhej të ndodhte një gjë e tillë. Tutje duke ju referuar propozimit të nënkyetarit të komunës tha se pajtohet me atë propozim që të financohet projekti i propozuar nga ai por, se nuk pajtohet se nga pozicioni “Botimi i librave” të merret krejt ajo shumë e dedikuar për këtë çështje, për faktin se ka shumë autor të ri të cilët duhet të përkrahen gjatë këtij viti. Lidhur me këtë çështje propozoi që nga secili pozicion të hiqen nga 100 deri në 200 € dhe kjo shumë të arrihet për financimin e këtij projekti. Në fund pyeti se përsë tifozërisë “Forca” këtë vit i janë ndarë vetëm 500 € kur dihet fakti se tradicionalisht këtyre tifozëve i janë ndarë nga 800 € andaj pyeti se mos kjo është bërë për faktin se këta tifoz kanë marrë pjesë në protestat e organzuara nga opozita në nivelin qendror të institucioneve kundër dy marrëveshjeve të lidhura me Serbin.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit-propozoi që shoqatës “Ato” ti rritet shuma e subvencioneve.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –lidhur me çështjet që i shtruan anëtaret e kuvendit të sipër cekur tha se tifozeria “Forca” nuk është mirë të infiltrohet në asnjë subjekt politikë por të zhvilloj aktivitetin e saj ashtu si i ka hije dhe njoftoi se këtyre tifozëve në të kaluarën i janë ndarë deri në 3,000 € për zhvillimin e aktivitetave të tyre. Ndërsa lidhur me çështjen e statusit juridik të klubeve njofto se në material të kuvendit është prezantuar dokumentacioni me të cilën definohet se të gjitha klubet janë me status OJQ dhe se subvencionimi i tyre bëhet konform dispozitave ligjore. Në fund ai hedhi në votim propozim-vendimin për shpërndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive, me propozimin e dhe dhënë nga nënkyetari i komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 27 vota “për”, tjerat “abstenum” vendosi me sa vijon:

1.1. Me këtë Vendim ndahen mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2016, në shumën prej tridhjetë e tre mijë e pesë qind euro (33.500.00 €) për klube dhe shoqata sportive si më poshtë:

• KB “Kosova”.....	500.00 €;
• KB “Vushtrria”.....	500.00 €;
• KBB “Kosova” F.....	1500.00 €;
• KBB “Kosova” M.....	2000.00 €;
• KBB “Vushtrria Basket”	1200.00 €;
• KF “El Clasico”.....	300.00 €;
• KGJ “Kosova”	350.00 €;
• KH “Kosova”-F	2800.00 €;
• KH “Kosova”-M	3100.00 €;
• KH “Samadrexha”-M.....	2800.00 €;
• KH “Samadrexha”-F.....	2800.00 €;
• KickBox “Kosova”.....	1200.00 €;
• KM “Kosova”.....	500.00 €;
• KPP “Hasan Prishtina”.....	700.00 €;
• KPP “Vushtrria”	600.00 €;
• KSH “Llamkos”.....	800.00 €;
• KSH “Shqiponja”	800.00 €;
• KSH “Ura e Gurit”.....	400.00 €;
• KV “As Vushtrria”.....	1200.00 €;
• KV “Gjimnazisti”.....	800.00 €;
• KV “Vushtrria”-F.....	1400.00 €;
• KV “ Vushtrria”.....	800.00 €;
• SHP “Sitnica”.....	300.00 €;
• SHPKF SSH	300.00 €;
• KXH “Vicianum”.....	400.00 €;
• KXH “Studenti”.....	400.00 €;
• K.Atlekies “Kosova”.....	350.00 €;
• Tifozeria FORCA.....	500.00 €;
• Stimulim për suksese të klubeve.....	4,200.00 €;
Gjithsejtë:	33.500.00 €.

2.Mjetet në shumën e cekur si në pikën paraprake, të shpërndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës aprovohet lista e subvencioneve për vitin 2016 sipas pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.Me këtë vendim aprovohet lista e subvencioneve për vitin 2016, sipas prioriteteve të përcaktuara me buxhetin e komunës për vitin 2016, në bazë të pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1 Në zyrën e Kryetarit, subvencione ndahen për këto kategori:

1.1.1 Subvencione për raste të veçanta	8,000.00 €
1.1.2 Subvencione për dekorata.....	2,000.00 €

2. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale subvencionet ndahen për këto kategorit:

2.1 Subvencion Shoqatës së Familjeve te dëshmorëve.....	3,000.00 €
2.2 Subvencion Organizatës së veteranëve të luftës.....	3,000.00 €
2.3 Subvencion Shoqatës së martirëve të luftës.....	3,000.00 €
2.4 Subvencion Shoqatës së invalidëve të luftës.....	3,000.00 €
2.5 Subvencion Shoqatës së të burgosurve politikë.....	3,000.00 €
2.6 Shoqata e të verbërve.....	3,000.00 €
2.7 Subvencion OJQ "ATO".....	500.00 €
2.8 Subvencion Hendikosit.....	12,000.00 €
2.9 Ndihmë me zahire familjeve skamnore.....	4,000.00 €
2.10 Ndihme për strehim (Qiraja).....	24,000.00 €
2.11 Shoqata e të shurdhërve.....	1,000.00 €
2.12 Bashkëfinancim me donatore.....	4,000.00 €
2.13 Ndihme për shërim.....	16,500.00 €

3.Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, subvencionet ndahen për këto kategorit:

3.1 Organizata rinore dhe organizata tjera.....	4,000.00 €
3.2 Dita e ZOSH-it.....	1,000.00 €
3.3 Aktivitete Kulturore, Rinore, Sportive.....	4,000.00 €
3.4 Klubet dhe Shoqatat Sportive.....	33,500.00 €
3.5 Turniri i shahut 2 Maj.....	1,000.00 €
3.6 Turniri i hendbollit Jeton Tërstena TOTA.....	1,000.00 €
3.7 Projektit Shkencor, "Batalioni IV Rexhep Musa".....	5,000.00 €
3.8 Takimi i Poeteshave	2,000.00 €
3.9 Teatri i Qytetit.....	3,500.00 €
3.10 Panairi i shkencës dhe kulturës-OJQ "Lëvizja Koha".....	1,000.00 €
3.11 Muaji i pikturës OJQ "Kult Studio".....	800.00 €
3.12 Drama "Ibrahimë dhe Lulet e Kurianit".....	1,500.00 €
3.13 Aktiviteti Thank you USA me Miqtë e Amerikës.....	1,700.00 €

4. Në Drejtorinë për Arsim, subvencionet ndahen për këto kategorit:

4.1 Bursat e studentëve.....	18,500.00 €
4.2 Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.....	10,000.00 €
4.3 Përkrashja e nxënësve për aktivitete të lira.....	4,414.00 €
4.4 Shuma totale e subvencioneve për vitin 2016 është.....	182,914.00€

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Arsim.

7.Shqyrtim i Propozim-Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat kadastrale: nr.P-70202050-01001-0,me kulturë arë e klasës së 4 (katërt),vendi i quajtur ‘Kuposi Tushpija me sipërfaqe prej $283.55m^2$ të marr nga sipërfaqja e përgjithshme $462m^2$, P-70202050-01002-0 me kulturë arë e klasës së e klasës së 4 (katërt),vendi i quajtur “Tu Mullini” me sipërfaqe prej $152.94m^2$ të marr nga sipërfaqja e përgjithshme $530m^2$ dhe P-70202050-01003-0 me kulturë arë e klasës së e klasës së 4 (katërt),vendi i quajtur ‘Ara Tushpija me sipërfaqe prej $263.51m^2$ të marr nga sipërfaqja e përgjithshme $1024m^2$ të evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të datës 09.10.2015,Zona Kadastrale Sumë me pronar Nexhat (Hamdi) Ferizi.

2. Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij është me qëllim të Ndërtimit të objektit – Zgjerimi i kapacitetit të fabrikës përpunimin e mishit.

3.Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirë për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij Vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4.Obligohenet pronari i ngastrës nga pika 1 e këtij Vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 “a” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, ku parashihet $1.00 \text{ €}/m^2$ përmes organit për bujqësi të KK-së Vushtrri.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtorin për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

8.Të ndryshme.

a).*Shqyrtimi i parashtresës për lidhjen e pajtimit gjyqësor me Istref Pushkollin.*

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim përfaqësuesi i autorizuar i Komunës z. Idriz Muzaqi autorizohet që të arrijë pajtim gjyqësor me përfaqësuesin e autorizuar të Istref Pushkollit lidhur me lëndën CN.nr. 157/15, që në emër të shpronësimit të sipërfaqes së tokës prej $21 m^2$ dhe objekteve tjera përcjellëse ashtu që Istref Pushkollit t'i kompensohet shuma e mjeteve financiare në vlerë prej $6,176.08\text{€}$.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohenet: Kryetari i Komunës dhe Zyra Ligjore.

b). *Pyetet e anëtarëve të kuvendit.*

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit-shtroi se shumë të nevojshme që komuna të bëjë kërkesë në Ministrin e Infrastrukturës për vendosjen e një semafori tek rruga e fshatit Begaj në rrugën maxhistrale përfaktin se në këtë vend kemi mjaft shumë tollovi dhe shpesh ndodhin aksidente trafiku shpesh herë me fatalitet për qytetaret tanë.

Dibran Perçuku, nënkryetar i komunës-tha se propozim i anëtarit të kuvendit Hysni Gërguri është shumë i qëlluar dhe njoftoi se nga buxheti qendror kemi një shumë të mjeteve financiare në vlerë prej 350,000.00 € dhe me këtë është paraparë një projekt dy vjeçar për rregullimin e maxhistralës Prishtinë-Mitrovicë e cila në një pjesë kalon nëpër qytetin e Vushtrrisë andaj ky projekt është paraparë të realizohet në tre segmente dhe atë: segmenti i parë është prej marketit "Emona" deri në dalje të Vushtrrisë tek ish "Jugo Petrolli" e që është menduar një rrugë me dy korsi dhe me trotuar nga 2m në se secilën anë, rrugë për këmbësor si dhe stazë për biciklistë si dhe drunj dekorativ, në këtë projekt pritet që të vendosen samafor tek rruga e fshatit Begaj. Segmenti i dytë i kësaj rruge përfshihet prej "Emonës" dhe vazhdon deri tek rreth rrotullimi që vjen nga autostrada që e anashkalon qytetin. Si dhe segmenti i tret që përfshihet nga dalja e Vushtrrisë deri tek fshati Smrekonicë.


Mbledhja përfundoi në orën 10:57.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit

